



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), më datë 04.06.2014, realizoi vizitë për rikontroll në ENK Shtip. MPN-ja këtë vizitë e realizoi në shoqërimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Shoqatës së Psikiatërve, si dhe të Shoqatës së Foreznikëve nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, në bazë të nënshkrimit paraprak të Memorandumit për bashkëpunim.

MPN-ja realizoi vizitë të paparalajmëruar për rikontroll në ENK në kuadër të mandatit dhe kompetencave të cilat burojnë nga Protokolli Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese dhe ndëshkuese dhe Ligji për Avokatin e Popullit. Kjo vizitë pasoi pas vizitës së rregullt të cilën MPN e realizoi në këtë burg më datë 22 dhe 23.05.2014 për çka hartoi Raport të veçantë me konstatime dhe rekomandime përkatëse të cilat iu dërguan drejtorisë së Entit Ndëshkues-Korrektues dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë.

Vizita në burg u zbatua në disa hapa. Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional fillimisht zhvilloi bisedë me ekipin udhëheqës të ENK Shtip të drejtuar nga drejtori, me ç'rast MPN u nda në dy ekipe. Ekipi i parë e vizitoi Repartin e Mbyllur dhe dhomat e izolimit, si dhe pjesën e shëndetësisë (ambulancën), ndërsa ekipi i dytë e vizitoi Repartin e Pranimit, Repartin Gjysmë të Hapur, si dhe zbatoi këqyrje në kuzhinë dhe palestër. Gjatë kohës së vizitës, në reparte u zhvilluan biseda me personat e dënuar. Gjithashtu, MPN-ja zhvilloi bisedë me Sektorin për Mbrojtje Shëndetësore, bëri këqyrje në disa kartonë shëndetësorë në bazë të ankesave të pranuara, këqyrje në librat për shqiptimin e masës izolim, përdorimin e mjeteve të dhunës, si dhe këqyrje mbi disa dosje profesionale të cilat i udhëheq Sektori për Risocializim.

Gjatë vizitës për rikontroll u konstatua se nga numri i përgjithshëm i rekomandimeve të dhëna 8 prej tyre janë zbatuar, 6 nuk janë zbatuar dhe 5 janë zbatuar pjesërisht.

Në vizitën e realizuar për rikontroll, MPN-ja u informua se deri para një periudhe të caktuar kanë qenë të punësuar 2 mjekë dhe 2 teknikë mjekësorë, por 1 mjek dhe 1 teknik mjekësor e kanë lënë punën. Për shkak të marrjes së pritshme të pjesës së shëndetësisë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, nuk mund të kërkohet plotësimi i vendeve të boshatisura. Nga periudha e vizitës së fundit në ENK Shtip është organizuar edukimi shëndetësor për të gjithë të punësuarit por edhe për të gjithë të dënuarit, me ç'rast janë përfshirë më shumë tema (tuberkulozi, HIV/SIDA, Hepatit C). Personat të cilët janë me terapi metadoni të njëjtën e pranojnë me rregull, për më tepër ata nuk kanë bërë kontroll ekzaminues nga ana e psikiatrit sa i përket dozës të cilën e pranojnë, përkatësisht të njëjtën e pranojnë me muaj rresht pa bërë kontroll ekzaminimi të kohëpaskohshëm.

Të gjithë personat e dënuar u ankuan për problemet që kanë me furnizimin jo të rregullt me ujë, i cili nga aspekti kimik nuk i përmbush kriteret, përkatësisht përdoret vetëm si ujë teknik, ndërsa me ujë të pijshëm furnizohen nga cisternat. Në përputhje me konkluzionet e

bashkëpunëtorëve të jashtëm të MPN-së, nevojitet zgjidhja e problemit të cilin e kanë me furnizimin e vazhdueshëm të ujit i cili nga aspekti kimik nuk i përmbush kriteret, përkatësisht i cili përdoret vetëm si ujë teknik, ndërsa me ujë të pijshëm furnizohen nga cisterna. Kjo çështje duhet të zgjidhet sepse mossigurimi i ujit, i cili nuk i përmbush kriteret nga aspekti kimik dhe bakteriologjik mund të rezultojë me shfaqjen e sëmundjeve infektive në formën e një epidemie tek personat e dënuar, e që epilogu mund të rezultojë me vdekje në qoftë se nuk hospitalizohen me kohë, veçanërisht gjatë periudhës së verës kur mundësia nga sëmundjet infektive është më e madhe.

Në kohën derisa realizohej vizita, përkatësisht gjatë bisedës me mjekun, MPN-ja u informua se akoma është aktual problemi me kartonët shëndetësorë të personave të transferuar nga burgjet e tjera. Ekipi i MPN-së bëri këqyrje në kartonët shëndetësorë të personave të cilët janë transferuar nga burgjet e tjera, me ç'rast u konstatua se gjatë transferimit nga burgjet e tjera nuk është bartur dokumentacioni i tyre shëndetësor dhe për këtë shkak mjeku nuk ka këqyrje mbi gjendjen e tyre shëndetësore ose terapinë e përshtetur. Kjo paraqet pengesë të madhe sa i përket marrjes së vazhdueshme të terapisë, veçanërisht në raste të gjendjeve kronike për të cilat nevojitet kohë dhe mjete për diagnostifikim të sërishëm ose evaluim të gjendjes shëndetësore të personave të dënuar. Si problem i posaçëm u theksua mosdërgimi i dokumentacionit nga ENK "Idrizovë", kështu që mjeku të njëjtin duhet ta kërkojë në mënyrë plotësuese.

Në këtë drejtim, u dha rekomandim që të bëhet rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit në burg edhe atë për disa aspekte, si për ruajtjen e shëndetit të personave të dënuar, ashtu edhe për parandalimin e shfaqjes dhe përhapjes së më shumë sëmundjeve, si dhe të përgatitet protokoll për transferimin e personit të dënuar nga një institucion ndëshkues në tjetër, i cili do ta përfshijë edhe bartjen e dokumentacionit mjekësor.

Gjatë vizitës për rikontroll, MPN-ja zhvilloi bisedë me një numër të madh të personave të dënuar nga më shumë reparte, ku trajtimi i Sektorit për Sigurim në përgjithësi u vlerësua si korrekt, përkatësisht numri më i madh i personave të dënuar ishin të kënaqur nga sjellja e shërbimit për sigurim, si dhe nga Sektori për Risocializim (edukatorët amë). Por, megjithatë, një pjesë e personave të dënuar u ankuan për përdorimin e forcës fizike nga Sektori i Sigurimit.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional përpiloi raport të veçantë në të cilin e konstatoi nivelin e rekomandimeve të zbatuara dhe u dha sugjerime përkatëse Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe ENK Shtip.